



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

VENDIM

Nr. 97, Datë 15/12/2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.57
DATË 28.12.2015 “PER SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË BASHKINË BERAT” I NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak i mbledhur ne datën 15.12.2017, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Kryetari i Bashkisë , mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 9, neni 35, neni 54 ; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

VENDOSI:

1. Në VKB nr.57 date 28.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat” i ndryshuar, të bëhen ndryshime në pikat e paraqitura si më poshtë vijon :

➤ Në pikën **II.TARIFAT VENDORE**, në kategorinë :

4.TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

Në pjesën “**Sqarime**” të tabelës , në piken

- Rrugët dhe sheshet ku do të shtrihet parkimi me pagesë janë , paragrafi :
-Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti banka “Raiffeisen” – rruga “Fan Noli”).

Ndryshohet me këtë përmbajtje :

- Përgjatë pjesës së dytë të Bulevardit “Republika” (segmenti shkolla “Babe Dude Karbunara” – rruga “Fan Noli”).

4. “TARIFA E ZËNIE SË HAPSIRËS PUBLIKE”

Në pjesën “**Sqarime**” të tabelës , paragrafi:

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë dhe vjeshtë (9 muaj/vit).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

Ndryshohet me këtë përmbajtje :

- Lejohet që periudha e vendosjes së tavolinave të lokaleve (bareve) jashtë njësisë, të jetë periudha pranverë, verë, vjeshtë, dimër (12 muaj/vit).
- **Ne piken 11. “TARIFA TË TJERA TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE” të hiqet kategoria VII. “Tarifa të ujit”**
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tregjeve, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Transportit , Emergjencave dhe Shërbimeve, si dhe Policia Bashkiake .

KRYEATARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Nikolëta MANKA



Vendimi u miratua :

Numri prezent: 29

Vota pro : 29

Vota kundër : -

Abstenim : -